

Në fillimet e mia si infermiere familjeje, përballja me pacientët ishte e vështirë për shkak të mungesës së pajisjeve dhe aftësive praktike. Shpesh detyrohesha t'i referoja pacientët në poliklinikën e qytetit edhe për shërbime të thjeshta, dhe ndihesha shumë keq për këtë.

Falë ndërhyrjeve të projektit HAP, veçanërisht pajisjes me çantën e infermierit dhe trajnimeve praktike, sot kam mjetet dhe aftësitë e nevojshme për të ofruar shumë procedura në qendrën tonë shëndetësore. Sot, ne vetë mund t'u ofrojmë pacientëve shërbime si lavazhi i veshit, oksigjenoterapia, EKG-ja dhe trajtimi i limfedemave, duke shmangur udhëtimet e panevojshme të pacientëve dhe duke përmirësuar ndjeshëm kujdesin shëndetësor në komunitet.

Eljona Troka
Infermiere



Para mbështetjes së HAP, në punën time të përditshme mungonin jo vetëm disa pajisje mjekësore, por sidomos protokollet e qarta dhe instrumentet për vendosjen e diagnozës dhe vlerësimin e riskut. Për shembull, dislipidemitë shpesh konsideroheshin vetëm në rastet kur pacientët ndiqeshin nga kardiologu, ndërsa në kujdesin parësor nuk vlerësoheshin në mënyrë sistematike.

Pas trajnimit për dislipidemitë dhe përdorimit të instrumenteve për llogaritjen e riskut kardiovaskular, kam arritur të diagnostikoj, trajtoj dhe ndjek 267 pacientë të rinj që më parë nuk ishin vlerësuar. Sot, vlerësimi dhe ndjekja bëhen sipas protokollit, me fokus të qartë në parandalim.

Dr. Melsena Leknikaj
Mjeke familjeje



VLORË

Qendra Shëndetësore Novoselë

Para se të merrja shërbim shëndetësor në shtëpi, lëvizja ime ishte shumë e kufizuar për shkak të hemiplegjisë, dhe ishte pothuajse e pamundur të shkoja rregullisht në qendrën shëndetësore. Kjo e bënte të vështirë ndjekjen e trajtimit tim dhe parandalimin e komplikacioneve si plagët e presionit, infeksionet urinare dhe problemet respiratore.

Falë vizitave të rregullta të infermiereve në shtëpi dhe pajisjes mbështetëse mundësuar nga projekti HAP, gjendja ime shëndetësore monitorohet rregullisht dhe unë lëviz më me lehtësi. Kam marrë këshilla për pozicionimin, higjienën dhe kujdesin e nevojshëm, dhe familjarët e mi janë më të përgatitur për të më ndihmuar.

Sot ndihem më i pavarur, më i sigurt dhe më i mbështetur, dhe trajtimi im ndiqet rregullisht pa pasur nevojë të udhëtoj larg.

Sokrat B.
Pacient



Deri rishtazi, roli i psikologut në Kujdesin Shëndetësor Parësor ishte ende i paqartë në nivel institucional duke qenë një rol relativisht i ri. Në punën e përditshme në Qendrën Socio-Shëndetësore Nr. 8 në Tiranë, mungonin udhëzime të strukturuar që të orientonin funksionin, përgjegjësitë dhe bashkëpunimin me ekipin shëndetësor.

Përfshirja ime në grupin konsultues për hartimin e Manualit të Psikologut në KSHP, si dhe trajnimi për Udhëzuesin e Menaxhimit të Çrregullimeve të Shëndetit Mendor, pasuar nga Grupi i Kolegëve, ndihmuan që përvoja praktike të refleктоhej në dokumente konkrete pune. Sot roli im është më i qartë, më i strukturuar dhe më i integruar në shërbimet e kujdesit parësor.

Majlinda Xhika
Psikologe



Përpara mbështetjes së HAP, përballeshim me mungesë protokollesh të standardizuara dhe të përditësuara, mungesë trajnimesh praktike dhe pajisjesh bazë që do të mbështesnin realisht punën tonë në Shërbimin Shëndetësor Parësor. Kjo e vështirësonte organizimin e punës dhe ofrimin e një shërbimi cilësor në terren.

Mbështetja e HAP solli protokolle të përditësuara, trajnime me fokus praktik dhe pajisje logjistike për NJVKSH-në dhe qendrat shëndetësore. Veçanërisht i rëndësishëm ka qenë edhe mbështetja për ngritjen e Grupeve të Kolegëve dhe monitorimin e zbatimit të protokolleve. Sot, puna jonë është më e strukturuar, më e koordinuar dhe më efektive.

Dr. Alba Muka
Mjeke specialiste



Mungesa e materialeve dhe pajisjeve mjekësore në të shkuarën na e vështirësonte ndjeshëm punën tonë dhe shpesh na detyronte të referonim pacientët drejt spitalit, duke krijuar vonesa dhe vështirësi shtesë, veçanërisht për pacientët me lëvizshmëri të kufizuar.

Falë mbështetjes së HAP, përmes sigurimit të pajisjeve dhe trajnimeve të specializuara, kapacitetet e stafit janë përmirësuar ndjeshëm. Sot, ofrojmë më shumë shërbime në banesë, me siguri dhe efikasitet më të lartë. Si rezultat, është rritur cilësia e kujdesit, si edhe besimi dhe kënaqësia e pacientëve, të cilët ndihen më të mbështetur dhe më të sigurt në komunitetin e tyre.

Brikena Shuka
Infermiere



TIRANË

Qendra Shëndetësore Nr. 2

Para se të merrja pjesë në trajnimet e HAP, puna ime me pacientët kronikë mbështetej kryesisht në përvojën personale dhe burimet ekzistuese në qendër. Kisha nevojë për udhëzime më të qarta dhe praktike për vlerësimin dhe menaxhimin e sëmundjeve kronike në kujdesin parësor.

Falë trajnimeve për sëmundjet kronike, udhëzuesve dhe protokolleve që morëm nga HAP, kam përmirësuar mënyrën e vlerësimit të pacientëve dhe dhënien e këshillave të thjeshta për menaxhimin e diabetit, hipertensionit, astmës, SPOK-ut dhe dislipidemisë.

Dr. Vilma Palluqi
Mjeke familjeje



VLORË

Qendra Shëndetësore Novoselë

Kisha dëgjuar nga kolegë për projektin HAP dhe ndikimin pozitiv që kishte pasur në punën e tyre. Ata tregonin se, pas trajnimeve dhe pajisjes me mjete ekzaminuese, puna ishte bërë më e lehtë dhe më efektive.

Pas fillimit të trajnimeve edhe në qendrën tonë shëndetësore, e përjetova vetë këtë ndryshim. Ndërhyrja e HAP nuk u kufizua vetëm në furnizimin me pajisje më të mira diagnostikuese, por edhe në trajnime mbi organizimin e punës. Kjo na ka ndihmuar të diagnostikojmë më saktë dhe të punojmë më mirë si ekip.

Dr. Arben Xhuveli
Mjek familjeje dhe drejtor



Para trajnimit për trajnerë të organizuar nga HAP, nuk isha e qartë për mundësitë që mund të ofronte roli im si psikologe në Qendrën Shëndetësore përtej funksionit bazë. Mungesa e trajnimeve të strukturuar dhe e udhëzimeve konkrete e bënte të paqartë bashkëpunimin me stafin mjekësor dhe ndërhyrjen në rastet e shëndetit mendor.

Trajnimet e specializuara, Grupet e Kolegëve dhe përfshirja në hartimin e manualit për psikologët sollën qartësi profesionale dhe instrumente praktike pune. Sot, puna është më e strukturuar, bashkëpunimi me mjekët është përmirësuar dhe qasja ndaj pacientëve me probleme të shëndetit mendor është më gjithëpërfshirëse dhe më efektive.

Albana Xhemali
Psikologe



Përpara se HAP të prezantonte kujdesin në banesë, shërbimi shëndetësor për pacientët kronikë dhe me aftësi të kufizuara ishte mjaft i vështirë, pasi vizitat në qendër ishin shpesh të pamundura për ta. Një nga pacientët që ndjek rregullisht është e diagnostikuar me insuficiencë renale kronike dhe insuficiencë respiratore, dhe lodhja e vazhdueshme e bënte të vështirë paraqitjen në QSH.

Falë mbështetjes së HAP dhe zbatimit të kujdesit në banesë, monitorojmë rregullisht parametrat kryesorë shëndetësorë dhe ofrojmë këshillim praktik për trajtimin dhe dietën. Gjithashtu, falë pajisjeve të mundësuar nga HAP, pacientes tashmë i ofrojmë edhe oksigjenoterapi në shtëpi. Sot, kujdesi është më i vazhdueshëm, më i sigurt dhe më pranë pacientëve dhe familjeve të tyre.

Floriana Shehaj
Infermiere





Festa të gëzura!